



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III

Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale
Mbledhja nr. 5
Prishtinë, më 18 mars 2008, ora 13:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

PROCESVERBAL
i mbledhjes së Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale

Morën pjesë: Sadik Idriz, Rita Hajzeraj, Teutë Hadri, Flora Brovina, Nurishahe Hulaj, Armend Zemaj, Gjylnaze Sylja, Qamile Morina, Mimoza Ahmetaj.

Munguan: Slobodan Petroviq dhe Bujar Bukoshi.

Të pranishëm:

Nga Zyra e Komisioneve të Kuvendit: Shpresa Haxhijaj dhe Fatime Qorri;
Nga Zyra e Presidentit të Kosovës: Nexhat Shatri
Nga OSBE: Lejla Selimi
Nga NDI: Shefki Kastrati

Mbledhjen e kryesoi z. **Sadik Idriz**, kryetar i Komisionit
Komisioni i zhvilloi punimet me këtë

REND DITE

1. Miratimi i rendit të ditës
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar
3. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit të Inspektoratit të Punës
4. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për skemën e ndihmës sociale në Kosovë
5. Shqyrtimi i Projektligjit për rehabilitimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara
6. Shqyrtimi i Projektligjit për përkrahje materiale të familjeve të fëmijëve me aftësi të përhershme të kufizuara
7. Të ndryshme

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa plotësime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar

Gjylnaze Syla - Lidhur me procesverbalin e mbledhjes së kaluar tha se në faqen dy fjala “historian” duhet të jetë “historinë”, në faqe dy shprehja e fundit që referohet në “Ligjin ekzistues për inspektoratet” duhet të jetë në “Rregulloren e UNMIK-ut për Degën e Ekzekutivit”, pastaj në faqen katër, jo konventa e “Ivos”, por konventa e “ILO-s”, si dhe në procesverbal duhet të futet kostoja e themelimit të Agjencionit.

Procesverbali i mbledhjes së kaluar u miratua me vërejtjet e cekura më lart.

3. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit të Inspektoratit të Punës

Sadik Idriz - Tha se për këtë Projektligj raportuese është Gjylnaze Syla dhe hap diskutimin lidhur me këtë pikë të rendit të ditës.

Mimoza Ahmetaj - Lidhur me Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit të Inspektoratit të Punës, propozoi të shtyhet deri pas miratimit të Ligjit themelor të punës, që parashihet të arrijë në mars sipas planit strategjik. Ajo konsideron se ky Projektligj nuk është me ndonjë urgjencë.

Sadik Idriz - Theksoi se atë që e ka përgatitur Gjylnaze Syla shkon në favor të diskutimit të mbledhjes së kaluar. Çështja përmbajtjesore këtu është të kthehet ashtu siç është në Ligjin bazik, pra të mos formohet Agjencioni Ekzekutiv, por të mbetet Inspektorat dhe këtu nuk ka asgjë konfuze. Ai fjalën ia dha raportueses për të shtuar diçka.

Gjylnaze Syla - Nuk kishte të shtonte asgjë, përpos asaj që ka paraqitur në raportin e mbledhjes së kaluar, por njëherësh ajo tha se ka një dyshim lidhur me propozimin që ajo e ka bërë për ndryshimin e amendamenteve të veçanta, në pjesën që ka të bëjë me atë që zgjedhjen e kryeinspektorit ta bëjë Këshilli për Emërime të Larta Publike. Ajo vlerëson se një gjë e tillë nuk është e drejtë. Më e drejtë është që këtë zgjedhje të bëjë Ministria.

Flora Brovina - Tha se pajtohet me amendamentet e propozuara. Gjithashtu theksoi se edhe në mandatin e kaluar ka insistuar që asnjë ligj, që ka të bëjë me rregullat e punës, të mos aprovohet pa u nxjerrë Ligji i Punës. Ligji i Inspektoratit të Punës ekziston, por ky ligj prapë ka për të pësuar ndryshime kur të kalojë Ligji i Punës. Në Projektligjin që po shqyrtohet në Komision nuk ka shumë dallime. I vetmi dallim është ai që Ministria prej fillimit e ka kërkuar. Me kërkesë ajo pajtohet që autoriteti i inspektorëve të punës ose vetë Ministria t'i zgjedhë kryeinspektorin dhe inspektorët komunalë, sepse inspektorët komunalë nuk e kanë pasur autoritetin-pavarësinë e duhur në kuadër të komunës.

Rita Hajzeraj -Lidhur me shqyrtimin e Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit të Inspektoratit të Punës dhe lidhur me propozimet e raportueses, tha se ka disa propozime shtesë. Ajo edhe pse në mbledhjen e kaluar i ka dëgjuar përfaqësuesit e Ministrisë për propozimet e tyre për plotësim dhe ndryshim të Ligjit, megjithatë ka hulumtuar dhe ka kontaktuar më shumë ekspertë, madje edhe me ekspertët që kanë punuar në këtë propozim dhe në bazë të kësaj ka vlerësuar se deri më tani kanë ekzistuar dualizma. Kjo e bën mendimin e saj të kundërt me atë që e paraqiti Flora Brovina, sepse deri më tani kanë ekzistuar inspektorët e emëruar nga Ministria dhe nuk kanë qenë të pavarur nga komuna. Këta inspektorë i kanë dhënë përgjegjësi komunës e jo Ministrisë. Ajo pajtohet me propozimin lidhur me themelimin e Agjencionit, sepse e konsideron se janë plotësuar dy kriteret e parapara për themelimin dhe sipas saj me themelimin e këtij Agjencioni të gjithë inspektorët, duke i përfshirë edhe ata komunalë, do të japin llogari para Ministrisë.

Sadik Idriz - Tha se e kupton që ka njerëz që janë të pajtimit të themelohet ky Agjencion dhe nuk përbën problem emërtimi, por ai konsideron se nuk zvogëlohen dualizmat nëse themelohet Agjencioni dhe prapë inspektorët komunalë t'i përgjigjen komunës.

Armend Zemaj - Pasi i përshëndeti të pranishmit propozoi të përkrahet ajo që e paraqiti raportuesja që ai e përgëzoi, por kërkoi të bëhet ndryshimi vetëm në nenin 2, pika 8, që emërimin e kryeinspektorit dhe të inspektorëve ta bëjë Ministria e jo Këshilli për Emërime të Larta Publike. Sipas tij përfaqësuesit e Ministrisë nuk kanë arritur t'i arsyetojnë mjaft propozimet e tyre për themelimin e Agjencionit Ekzekutiv. Ndërsa sa i përket propozimit për ta pritur Ligjin e punës ai vlerëson se kjo nuk duhet të jetë pengesë që të vazhdohet me ligjet e tjera.

Mimoza Ahmetaj - Tha se sipas raportit themelimi i Agjencionit Ekzekutiv ka implikime buxhetore dhe parashtrori pyetje për raportuesen se nëse mbetet Inspektorat, cilat do të ishin implikimet buxhetore dhe a do të thotë kjo se Inspektorati është në kuadër të Ministrisë dhe nuk ka implikime të tjera buxhetore?

Gjylnaze Syla - Theksoi se themelimi i Agjencionit ka implikime buxhetore, sepse parashihet shtimi i numrit të punëtorëve. Nëse mbetet Inspektorat atëherë kjo është në kuadër të Ministrisë dhe nuk ka implikime të tjera. Lidhur me çështjen e inspektorëve komunalë dhe me vështirësitë që shfaqen gjatë zbatimit të Ligjit, ajo propozoi që stafi mbështetës ta hulumtojë Ligjin për decentralizim, nëse diçka ndërlihet me faktin që inspektorët komunalë duhet t'i zgjedhë Kuvendi Komunal. Ajo mendon se nëse në atë Ligj ka ndonjë dispozitë ligjore që parasheh se inspektorët komunalë zgjidhen nga komuna atëherë diskutimi për inspektorët komunalë është i kotë. Sipas saj kjo duhet të hulumtohet në mënyrë që të bëhet harmonizimi.

Nurishahe Hulaj - Tha se në bazë të diskutimeve që janë bërë në këtë Komision konsideroj që kemi arritur në një përfundim në esencën e Ligjit. Tha se propozimet që i ka hartuar raportuesja e këtij Projektligji janë në rregull. Sa i përket konfuzitetit lidhur me Inspektoratin e Punës respektivisht Agjencionin, mendon se Komisioni duhet ta përfundojë këtë Ligj, në mënyrë që ata të mos mund të veprojnë më si Agjencion, por çdo gjë të jetë e bazuar në ligj.

Gjylnaze Syla - Ishte e mendimit të pritët Ligji për punën. Ka shumë paqartësi dhe nëse Komisioni pajtohet, ajo është e mendimit që seancës t'i propozohet të pritët derisa të nxirret Ligji për punën.

Nurishahe Hulaj – I njoftoi anëtarët e Komisionit për Ligjin për punë dhe sipas saj në mandatin e kaluar është thënë se për shkak të implikimeve të shumta buxhetore ai Ligj nuk do të mund të zbatohet diku deri në vitin 2011. Ajo shtroi pyetjen: Çka bën ky Agjencion, që është duke vepruar, deri në vitin 2011?

Sadik Idriz – E vuri në dyshim se a do të aprovohet në Kuvend Ligji për punë. Ai tha se edhe nëse aprovohet, ndoshta nuk zbatohet deri në vitin 2011. Sipas tij Komisioni duhet të vazhdojë me Ligjin, ashtu siç ka propozuar Gjylnaze Sylja, me një ndryshim të vetëm që ajo vetë e propozoi, që kryeinspektori të zgjidhet nga Ministria e jo nga Këshilli për Emërime të Larta Publike, ndërsa propozimet e tjera të rregullohen në aspektin teknik dhe ky Ligj të vazhdojë tutje në procedurë.

Kryetari i ftoi anëtarët e Komisionit për t'i votuar propozimamendamentet e raportueses Gjylnaze Sylja.

Kryetari i Komisionit konstatoi se me shumicë votash të anëtarëve të Komisionit dhe me një votë kundër u miratua ky propozim.

3. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për skemën e ndihmës sociale në Kosovë

Sadik Idriz - Tha se për këtë Projektligj raportuese janë: Mimoza Ahmetaj dhe Nurishahe Hulaj dhe hap diskutimin për këtë pikë të rendit të ditës.

Mimoza Ahmetaj - Përveç atyre ndryshimeve që ajo i ka paraqitur në formë të amendamenteve, propozoi të kërkohet nga Ministria për Ekonomi dhe Financa se sa implikime buxhetore do të kërkonin amendamentet që ajo i ka bërë, d.m.th. mosha të shtyhet deri në 60 vjet, të konsiderohet fëmijë personi deri në 18 vjet, shkalla e invaliditetit nga 80% të zbrësë në 60%. Propozimin tjetër ajo e fokusoi në nenin 2, pika 1 dhe në paragrafin e fundit pika 3 **iii**, ku përmenden familjet e dëshmorëve, të invalidëve të luftës etj. Nëse ekziston një ligj që aktualisht është në zbatim për këto kategori atëherë të amendamentohet edhe ky nen, në mënyrë që Ligji për skemën sociale të mos ngarkohet me këtë kategori të njerëzve. Për vlerën prej pesë eurosh të kërkohet nga Ministria për Ekonomi dhe Financa që të bëhet harmonizimi me rritjen e çmimeve ose harmonizimi i pikëve me situatën në terren. Sipas saj nga analiza që e ka bërë Banka Botërore, nga këto 3.3 milionë që i teprojnë Ministrisë për Punë dhe Mirëqenie Sociale, me ndryshimet brenda P/ligjit nuk po përputhet askund kjo shifër. Kërkoi nga Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale ta përcaktojë si e vërtetoi shifrën 3.3 milionë euro dhe insistoi ta marrë përgjigjen.

Sadik Idriz - Tha se ajo që e ka përgatitur Mimoza është mjaft e mirë, por duhet të bazohet në diçka që quhet realitet. Propozuesit e këtij Projektligji kanë pasur probleme në terren, andaj kanë propozuar ndryshimet me qëllim që diçka të kursehet dhe brenda kësaj skeme të bëhet një balancë. Ai tha se në këtë mënyrë Komisioni nuk ka të drejtë të dalë me propozime që do t'i tejkalonin shifrat milionëshe. Mendon se propozimet e tilla kanë implikime të mëdha buxhetore.

Armend Zemaj - Tha se i kupton dëshirën dhe vullnetin që të përkrahet kjo kategori e njerëzve, por mundësitë janë shumë të vogla. Për propozimin e deputetes Mimoza Ahmetaj për ta shikuar bonitetin e tokës, mendon se kjo në Kosovë nuk është e mundshme. Pastaj lidhur me propozimin për mjetet motorike që krijojnë të ardhura, sipas tij, nëse futet ky nen atëherë si i tillë krijon mundësinë për keqpërdorime.

Teutë Hadri – E mbështeti atë që tha Armend Zemaj. Ajo tha se qëllimi i ndryshimit dhe i plotësimit të këtij Ligji ka qenë eliminimi i keqpërdorimeve. Atë që mund ta bëjë Komisioni është të amendamentohet Ligji në mënyrë që të jetë i zbatueshëm dhe të mënjanohen këto keqpërdorime.

Flora Brovina - Tha se i ka lexuar amendamentet e propozuara nga koleget. Sipas saj Ligji edhe në origjinal edhe pas përmirësimeve ka shumë për tu ndryshuar, së pari në shprehjet që nuk përdoren më si p.sh.: *“i paaftë për punë”*. Ajo është përpjekur që edhe vetë të bëjë amendamente që do t'i dorëzojë edhe me shkrim.

Rita Hajzeraj - Pajtohet me znj. Flora Brovina. Sa i përket Ligjit ajo propozoi, duke pasur parasysh se ky Ligj është shumë i rëndësishëm, nuk është mirë të vonohet.

Qamile Morina – Pyeti sa është kuota e udhëzimeve administrative në një ligj, pasi ka vërejtur se në shumë nene të këtij Ligji, ka mbështetje në udhëzime administrative.

Sadik Idriz - Tha se Mimoza Ahmetaj, Nurishahe Hulaj dhe Flora Brovina do t'i harmonizojnë amendamentet e propozuara dhe në mbledhjen e radhës do të votohet.

5. Shqyrtimi i Projektligjit për rehabilitimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara

Sadik Idriz – I njoftoi anëtarët e Komisionit se Projektligji për rehabilitimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara, ka kaluar nëpër Komision në mandatin e kaluar dhe është amendamentuar. Propozoi që raportuese të jetë znj. Flora Brovina, meqë ka punuar në këtë P/ligj edhe në mandatin e kaluar.

6. Shqyrtimi i Projektligjit për përkrahje materiale të familjeve të fëmijëve me aftësi të përhershme të kufizuara

Sadik Idriz - Tha se edhe ky Projektligj ka kaluar nëpër Komision në mandatin e kaluar, si dhe për të njëjtin Projektligj për raportuese e propozoi deputeten Flora Brovina, por ta ndihmojë Rita Hajzeraj.

Mbledhja e radhës do të mbahet të martën e ardhshme.

Kryetari e shpalli mbledhjen të përfunduar në orën 14:10

Përgatitur nga
Fatime Qorri- zyrtare ligjore

Zyra e Komisioneve të Kuvendit

*Kryetari i Komisionit,
Sadik Idriz*
